

VENDIM
Nr. 104, datë 22.4.2021

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË 29.1.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘AGETA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC ‘BORIE – LURË 1’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/1 prot., datë 15.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet të instaluar 1800 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 29.1.2021, ndër të tjera, ka vendosur:

“1. Të licencojë shoqërinë ‘Ageta’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të dokumentojë në ERE, brenda 3-muajve, miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k., si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, ‘Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrrenjve të kurores së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë ‘Bajrami N’.”.

- Në plotësim të kushtit të sipërcituar, shoqëria “Ageta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/5 prot., datë 13.4.2021, ka përcjellë një komunikim të MIE-s (*e-mail* datë 18.11.2020), nga i cili rezulton se kjo e fundit ka njohur shoqërinë “Ageta” sh.p.k. si zbatuese të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC ‘Borie – Lurë 1’ me kapacitet prodhues 1.8 mw, në rrjedhën e përrrenjve të Kurores së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër”.

- Sa më sipër, shoqëria “Ageta” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet të instaluar 1800 kw”.

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument i cili duhet t’i nënshtrohet procedurës së rinovimit, si referuar në konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27/2021, për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k. Aktualisht shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Neni 113, i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë parashikon mundësinë e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 e vendimit nr. 27, datë 29.1.2021, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti